



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Njoftim për vende të lira pune

Instituti i Statistikave (INSTAT), kërkon të punësojë punonjës me kontratë pune në pozicionet: “Operatorë GIS” për plotësimin e nevojave me punonjës mbështetës për kryerjen e aktivitetit “Përditësimi i hartave të zonave të censit 2019”.

TERMAT E REFERENCËS DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES PËR STAFIN NDIHMËS TË ANGAZHUAR NË ANKETËN E PËRDITËSIMIT TË HARTAVE TË ZONËS SË CENSIT 2019

Termat e referencës për Operatorë GIS

- Operatori GIS është personi përgjegjës për dixhitalizimin e hartës së zonës së censit si dhe mbështetjen dhe monitorimin e anketuesve në terren për përditësimin e informacionit gjeohapsinor, sipas udhëzimeve të përgatitura nga specialistët përkatës të INSTAT-it dhe rekomandimeve ndërkombëtare;
- Operatori është i detyruar të ndjekë me përgjegjësi trajnimin, që do të organizohet nga stafi i INSTAT si dhe të studiojë udhëzuesin përpara se të ushtrojë detyrën;
- Të ketë aftësi trajnuese;
- Operatori duhet të ketë paraqitje serioze në punë, të sillet në mënyrë korrekte, të jetë i komunikueshëm dhe i aftë për të kryer detyrën e kërkuar;
- Të ketë aftësi të mira të punës në grup;
- Të ketë aftësi të mira menaxheriale, duke qenë se do të jetë përgjegjës për një numër të caktuar anketuesish;
- Bazuar në Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, Operatori duhet të respektojë rregullat e konfidencialitetit;
- Për problemet e ndeshura gjatë punës të vihet në dijeni, stafi i INSTAT;
- Detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e Operatorit janë përcaktuar në udhëzuesin e anketës dhe nuk mund t’i transferohen personave të tretë;
- Të jetë i gatshëm të punojë me dy turne nëse do të jetë e nevojshme;
- Të jetë i gatshëm të për të punuar në terren për kontroll;

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Kriteret e përzgjedhjes së Operatorëve:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të jetë ndjekës i arsimit të lartë ose ta ketë përfunduar atë;
- Të ketë njohuri të mira në përdorimin e kompjuterit;
- Të jetë i aftë për t'u përshtatur shpejt me qasjet dhe teknologjitë e reja;
- Të jetë banor i bashkisë Tiranë;
- Të njohë shumë mirë paketën Microsoft Office™, njohuritë në ArcGIS/ AutoCAD përbëjnë avantazh;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Profili gjeografi, gjeologji, gjeoinformatikë, gjeodezi, arkitekturë dhe të ngjashme përbëjnë avantazh;
- Eksperiencë të mëparshme në punën me dixhitalizimin e hartave përbëjnë avantazh;
- Të jenë të papunë.

Për realizimin e dixhitalizimit të të dhënave gjeografike dhe monitorimit dhe mbështetjes së anketuesve në terren, do të rekrutohen **20 Operatorë** me kontratë pune për periudhën Mars – Dhjetor 2019.

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat si më poshtë:

1. Kërkesën për aplikim;
2. Curriculum Vitae të përditësuar me datën dhe firmën e personit;
3. Fotokopje e pasaportës ose e kartës së identitetit
4. Fotokopje diplome të mesme /lartë / Vërtetim i ndjekjes së shkollës së lartë

Dokumentat duhet të dorëzohen brënda datës 23.02.2019, pranë zyrave qendrore të Institutit të Statistikave në Tiranë, në adresën : “Institutit i Statistikave, Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1,Tiranë”,

Vendi, data dhe ora e intervistës do të publikohen në faqen zyrtare të INSTAT brënda 5 ditëve nga përfundimi i datës së aplikimit.

Kandidatët fitues do të njoftohen për datën e zhvillimit të trajnimit dhe në momentin e paraqitjes duhet të kenë me vete dokumentet e mëposhtme:

1. Vërtetim vendbanimi;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

2. Karte identiteti (ID) /pashaportë

Mungesa në trajnim si dhe paraqitja pa këto dokumente çon në skualifikimin e kandidatit fitues.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1, Njësia Administrative Nr.2, 1017

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al